



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit  
P-106  
Prishtinë, më 8 qershor 2010, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 8 QERSHOR 2010

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Naim Maloku dhe Hetem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Lulzim Zeneli, Xhezair Murati dhe Branislav Grbiq;

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Lumnije Murati  
Nga ICO: Blerta Bejtullahu, dhe  
Nga OSBE, Lejla Selimi.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

### **R e n d   t ë   d i t ë s**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 qershor 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

\*\*\*

#### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 qershor 2010**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 qershor 2010, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **vendosi** që mbledhja e ardhshme e Kuvendi të mbahet më 17 qershor 2010, me këtë

### **R e n d   d i t e:**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për qasje në dokumente publike,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2009,
7. Shqyrtimi i Raportit të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009,
8. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2009,
10. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave,

### **3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.**

- 3.1 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Naim Rustemi lidhur me ndalesën e kompensimit për pjesëmarrje në seancën plenare të 15 prillit 2010

Kryesia, lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

Ndalesa e kompensimit 1/6 pjesë, përkatësisht 40 Euro, për mospjesëmarrje në seancë plenare, më 15 prill 2010, për deputetin Naim Rustemi, si dhe për 62 deputetë të tjerë, të cilët kanë munguar, është bërë mbi bazën e Rregullës 3 të Aneksit nr. 2. për të drejtat shtesë të deputetëve.

- 3.1 Njoftimi për vizitën zyrtare të Grupit Francez të Miqësisë në Kuvendin e Kosovës, nga data 14 – 18 qershor 2010

Kryesia, pasi u njoftua për vizitën e Grupit të Miqësisë, mori këtë:

#### **V E N D I M**

Për Grupin Francez të Miqësisë, në përbërje prej shtatë (7) deputetëve dhe dy (2) zyrtarëve të administratës së Asamblesë Nacionale të Francës, që do ta vizitojnë Kuvendin e Kosovës, prej 14 – 18 qershor 2010, Kuvendi do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet e qëndrimit, të akomodimit dhe drekat zyrtare.

- 3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar për Integrim për lejimin e vizitës zyrtare në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Lejohet vizita zyrtare në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, prej 15-20 ose prej 25-30 qershor 2010, të anëtarëve të Grupit Parlamentar për Integrim, në këtë përbërje: Branisllav Grbiq, Vezira Emrush, Numan Baliq, Danush Ademi dhe Dragisha Miriq, si dhe të një përkthyesi nga administrata e Kuvendit.
2. Shpenzimet e qëndrimit dhe të akomodimit i mbulon nikoqiri - Kuvendi i Shqipërisë, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë, nr. 03-V-094.

3.4 Kryesia u njoftua me shkresën e deputetes Besa Gaxheri, lidhur me vlerësimin e Agjencisë kundër Korrupsionit për konfliktin e interesit, si dhe me njoftimin e deputetit Bujar Dugoli, për realizimin e vizitës së tij në Itali.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën 11: 40 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

Hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale